

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË
(TIRANË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË)**

DHE

**BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË KOSOVËS “PJETËR BOGDANI”
(PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS)**

Tiranë, 2021

Dy titullarët, Piro Misha, në cilësinë e Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (në emër të BKSh-së) dhe Fazli Gajraku në cilësinë e Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" (në emër të BKK-së), në mbështetje të Marrëveshjes dypalëshe kulturore të Autoriteteve Eprore, nën të cilat BKSh dhe BKK ushtrojnë veprimtarinë, duke u nisur nga vullneti për t'i forcuar dhe thelluar marrëdhëniet nëpërmjet tyre si partnerë, këtu të quajtur palë, janë marrë vesh për sa më poshtë:

Neni 1
BASHKËPUNIMI I PALËVE

Palët do të bashkëndihmojnë në grumbullimin, pasurimin, ruajtjen, mirëmbajtjen e trashëgimisë kombëtare të shkruar dhe të shtypshkruar.

Neni 2
PROMOVIMI

Palët do të kontribuojnë në promovimin e trashëgimisë kulturore të shkruar kombëtare të dy vendeve përkatëse në portale europiane dhe botërore, përmes rrjetit botëror të informacionit.

Neni 3
SHKËMBIMI I BOTIMEVE

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimit të botimeve të tyre institucionale bibliografike dhe/ose shkencore.

Neni 4
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Palët do të ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimit të informacionit bibliografik dhe albanologjik, si dhe të objekteve të digjituara (dorëshkrime, antikuarë, harta, fotografi, periodikë etj.).

Neni 5
ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE BIBLIOTEKARE

Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e konferencave, seminareve, ekspozitave, panairove, promovimeve të botimeve të rëndësishme të autorëve dhe/ose studiuesve shqiptarë apo të huaj, veprimtarive të përbashkëta kulturore/shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 6

ORGANIZIMI I KONFERENCËS KOMBËTARE TË BIBLIOTEKONOMISË

Palët organizojnë një herë në dy vjet Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë. Çdo edicion i saj do të përkujdeset nga institucioni i vendit ku Konferenca mbledhet: Shqipëri (BKSh) ose Kosovë (BKK). Tema, data e mbledhjes së Konferencës dhe programi i veprimtarisë së saj propozohen nga një komitet i përbashkët bashkërendimi, i caktuar nga Drejtoritë e të dyja Institucioneve, dhe miratohen prej këtyre Drejtorive.

Neni 7

SHKËMBIMI I PËRVOJAVE BIBLIOTEKARE

Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën për formimin dhe kualifikimin e vijueshëm të bibliotekarëve, sipas kushteve, kërkesave dhe mundësive të ndërsjella.

Palët do të shkëmbejnë ekspertë të fushës së shkencës së bibliotekave dhe të informacionit në mënyrë që të këmbehen përvojat dhe arritjet e të dy bibliotekave, si dhe më synimin për të promovuar bashkëpunimin e tyre dypalësh.

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e shkencës së bibliotekave dhe të informacionit.

Palët do të vlerësojnë dhe shkëmbejnë përvojën bashkëkohore në fushën e shkencës së bibliotekave dhe të informacionit, komunikimit, teknologjive të reja përmes takimesh ekspertësh, seminaresh, vizitash profesionale etj.

Palët do të nxisin implementimin e teknologjive të reja të informacionit në proceset dhe shërbimet bibliotekare.

BKSh do të ofrojë ndihmesë profesionale dhe shkencore në përparimin e procesit të digjimitit në Kosovë nëpërmjet organizimit të seminareve apo veprimtarive trajnuese në Prishtinë apo Tiranë.

Neni 8

MBULIMI I SHPENZIMEVE PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE PËRKATËSE

Palët dakordohen që aktivitetet të organizohen proporcionalisht dhe shpenzimet financiare për realizimin e aktiviteteve të mbulohen sipas rendit pala pritëse mbulon shpenzimet.

Neni 9

AFATI KOHOR I REALIZIMIT TË MARRËVESHJES

Marrëveshja arrihet për afatin kohor brenda 4 vitesh dhe e njëjta mund të ripërtërihet në marrëveshje ndërmjet palëve.

**Neni 10
HYRJA NË FUQI**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Nënshkruar në Tiranë më 27/11/2021 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe,
të dyja tekstet njëlloj të vlefshme.

**PËR
BIBLIOTEKËN KOMBËTARE TË
SHQIPËRISË**

**DREJTOR
PIRO MISHA**



**PËR
BIBLIOTEKËN KOMBËTARE
TË
KOSOVËS "PJETËR
BOGDANI"**

**DREJTOR
FAZLI GAJRAKU**

